



# KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGIJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT



## NJOFTIM PËR OPINIONIN

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, solli vendim, me të cilin **kryhet ulja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 2,93 %** në raport me vendimin e datës 07.09.2020.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 ulen për 1,00 denarë/litër**, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i **EUROSUPER BS-95 do të jetë 58,50 den/l**, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i **EUROSUPER BS-98 do të jetë 60,50 den/l**.

Çmimi i shitjes me pakicë i **EURODIZEL (D-E V) dhe i Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1), do të ulet për 1,50 den/l dhe EURODIZEL (D-E V) dhe Vaji Ekstra i Lehtë për Amvisëri (EL-1) do të jetë 49,00 den/l**.

**Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU ulet për 1,407 den/kg dhe do të jetë 24,549 den/kg.**

Nga data 19.09.2020, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

|                    |                         |                          |
|--------------------|-------------------------|--------------------------|
| Benzinë për motorë | EUROSUPER BS - 95       | 58,50 (denarë/litër)     |
| Benzinë për motorë | EUROSUPER BS -98        | 60,50 (denarë/litër)     |
| Naftë për motorë   | EURODIZEL BS (D-E V)    | 49,00 (denarë/litër)     |
| Vaj për djegie     | Ekstra i Lehtë 1 (EL-1) | 49,00 (denarë/litër)     |
| Mazut M-1 SU       |                         | 24,549 (denarë/kilogram) |

Në periudhën e kaluar shtatëditore të gjitha **çmimet referente në bursat botërore**, mesatarisht shënojnë ulje edhe atë: të benzinës për 5,950 %, të naftës për 9,999 %, të vajit ekstra të lehtë për 9,239 % dhe të mazutit për 9,018% .

Në të njëjtën periudhë **kursi i denarit në raport me dollarin është më i lartë** për 0,496%.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 15.09.2020. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së ([https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin\\_en](https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en) datë 07.09.2020), janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 1. Çmimet e shitjes me pakicë të Eurodizelit dhe Eurosuper BS-95

|                    | Eurodizel (EUR) | EUROSUPER BS-95 (EUR) |
|--------------------|-----------------|-----------------------|
| Maqedonia e Veriut | 0,795           | 0,950                 |
| Austria            | 1,026           | 1,070                 |
| Bullgaria          | 0,933           | 0,923                 |
| Kroacia            | 1,150           | 1,233                 |
| Gjermania          | 1,067           | 1,290                 |
| Greqia             | 1,154           | 1,432                 |
| Italia             | 1,282           | 1,398                 |
| Hungaria           | 1,036           | 1,038                 |
| Sllovenia          | 1,000           | 1,004                 |